



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:261394
Datë: 20.12.2023
Numri i dokumentit: 05095613

C-IV-14-2040

Ankuesi

Xh Sh, Suharekë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 19 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit **PRZ006-0219 i datës 10 mars 2014** si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26 mars 2014, parashtuesi i ankesës dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRZ006-0219 i datës 10 mars 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (me tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve pensionale të papaguara për periudhën kohore 2003-2007 në shumë të paspecifikuar nga NSH “NBI Suhareka” (*në likuidim*). Ankuesi pohon se me rastin e marrjes së vendimit me të cilin AKP e ka refuzuar kërkesën e tij kinse i ka kaluar afati i parashkrimit prej 3 vite, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, meqenëse dispozitivi i këtij vendimi është në kundërshtim me arsyetimin, i njëanshëm, jo objektiv, i paqëndrueshëm dhe si i tillë nuk mund të qëndroj. Ankuesi më tej theksoi se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, konsiston në atë se AKP kryesisht vendimin e vet e bazon kinse ankuesi kërkesën për këto mjete e ka ushtruar pas afatit, pasi kanë kaluar 3 vjet, e që është në kundërshtim

me dispozitat e LMD-së, sepse të drejtat nga marrëdhënia e punës parashkruhen në afat prej 5 vitesh, afati absolut, mirëpo këto të drejta nuk parashkruhen, tatimet dhe obligime pensionale janë fikse dhe nuk kanë lidhje me afate meqenëse ndërmarrja i ka fsheh këto mjete, duke manipuluar, e që ka bërë delikt ekonomik dhe përgjegjësi penale për përgjegjësitë e saj. Ankuesi pohoi se ka themeluar marrëdhënie pune në këtë ndërmarrje prej datë 24 maj 1998, kurse e ka ndërprerë me datë 29 gusht 2007, kur edhe është bërë privatizimi i kësaj ndërmarrjeje. Ndërkaq tatimi dhe kontributi i pensionit nuk është paguar prej vitit 2003 deri në vitin 2007, pika 10.4 të Rregullores nr. 2003/13. Andaj Agjencia me këtë rast ka gabuar që nuk e ka aprovuar kërkesën e tij, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.L-034. Ankuesi i propozon gjykatës që ta abrogoj vendimin e AKP-së, kurse ankuesit t'ia lejon pagesën e tatimit në të ardhurat dhe kontributeve pensionale për periudhën 2003-2007. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij dorëzoi dëshmitë në kopje si: Vendimin e kundërshtuar dhe Librezën e tij të punës nr.955/85 (kopje e vërtetuar).

Me 19 shtator 2023, e paditura parashtrori mbrojtjen e saj, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Neni 74.2 të Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vet ankuesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086 ankesa në fjalë është e pabazuar. Neni 37, par.9.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në “Ligji i AKP-së”: *“Përveç bazave tjera për kundërshtim të kërkesës Autoriteti i Likuidimit gjithashtu ka të drejtë, pa kufizime që të kundërshtojë një kërkesë tërësisht apo pjesërisht bazuar në faktin që kërkesa është përmbushur në mënyra tjera”*. Neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr./L-034 për AKP-në parashikon: *“...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzim të kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitalit apo interesit të pronësisë...Kërkesa ose pretendimi është i pasafatshëm nga kufizimet kohore të aplikueshme”*. Neni 608 i LPB (publikuar në GZ Nr.53 të vitit 1976) i aplikueshëm sipas Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, parashikon se *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”*. Në bazë të dispozitave të mësipërme, kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj ankuesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Nuk ka asnjë provë përpara AL që ankuesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent. E paditura refuzon këtë kërkesë si të pavlefshme. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe të vërtetoj vendimet e AL në pajtim me nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj dorëzoi vetëm vendimin e kundërshtuar.

Me 29 shtator 2023 gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin përmes së cilit i dorëzoi mbrojtjen / përgjigjen e të paditurës në ankesë të datës 19 shtator 2023, për përgjigje. Me 09 tetor 2023 urdhri u pranua nga ankuesi mirëpo asnjë përgjigje nuk u dorëzua.

Për detaje tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRZ006-0219, datë 10 mars 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve pensionale të papaguara për periudhën kohore 2003-2007 në shumë të paspecifikuar nga NSH “NBI Suhareka” (*në likuidim*). Në ankesën e tij kundër vendimit të kundërshtuar ankuesi prapë nuk ka përcaktuar ndonjë shumë në emër të kërkesës së tij për kompensim të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve pensionale të papaguara.

Neni 37.9.9.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në, parasheh:

“Përveç bazave tjera për kundërshtim të kërkesës Autoriteti i Likuidimit gjithashtu ka të drejtë, pa kufizime që të kundërshtojë një kërkesë tërësisht apo pjesërisht bazuar në faktin që kërkesa është përmbushur në mënyra tjera”

Gjykata konsideron se AL drejt ka vendosur kur ka refuzuar kërkesën e ankuesit për kompensim të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve pensionale të papaguara për periudhën kohore 2003-2007 në shumë të paspecifikuar nga NSH “NBI Suhareka”, në kuptim të dispozitës së lartcekur. Siç dihet, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është autoriteti i vetëm i autorizuar për mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve pensionale në Republikën e Kosovës, andaj një zgjidhje tjetër nuk ishte e mundur. Kjo detyrë e ATK-së buron drejtpërdrejtë nga legjislacioni fiskal dhe tatimor dhe rrjedhimisht ATK kujdeset zyrtarisht për përmbushjen e detyrimeve të tilla nga të gjithë punëdhënësit pa dallim në Republikën e Kosovës. Prandaj, kërkesa e ankuesit me të drejtë është refuzuar, pasi e njëjta mund të jetë përmbushur në mënyra tjera.

Për më tepër, edhe nën supozimin se kërkesa e tij nuk është përmbushur në mënyra tjera, ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi relevante në mbështetje të kërkesës së tij për kompensim të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve pensionale të papaguara. Dëshmia e vetme e dorëzuar në këtë rast nga ankuesi është librezë e tij e punës, dëshmi e cila si e tillë nuk është relevante për themelësinë e kërkesës së ankuesit për kompensim të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve pensionale të papaguara.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të palëve por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar, prandaj si të tilla dhe refuzohen.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar